Lezhë, më 26.06.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 26.06.2023, në orën 10:00, në sallën e Bibliotekës "At Gjergj Fishta", Lezhë, mbi mbledhjen e parë të këshillit të Bashkisë Lezhë, dalë nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Fjala e hapjes dhe përshëndetëse u mbajt nga Sekretarja e këshillit Bashkiak, znj. Flojda Çunaj, e cila lexoi Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 662, dt. 09.06.2023 "Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 48, pika 5, mbledhja e parë e këshillit deri në zgjedhjen e Kryetarit të këshillit, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë.

Znj. Çunaj ftoi z. Pjetër Ndue Tushaj, i datëlindjes 14.02.1952 për drejtimin e mbledhjes.

z. Tushaj mbajti fjalën përshëndetëse dhe lexoi rendin e ditës të detajuar. Në vijim kërkoi propozime nga grupet e këshilltarëve për zgjedhjen e Komisionit të Mandateve.

Z. Kristian Gjiolodaj (Bashkë Fitojmë) propozoi znj. Flutura Gjoni.

z. Erin Ndreca (Partia Socialiste propozoi z. Dod Jaku, z. Klejvi Hoxhigi dhe znj. Dsimona Marku.

z. Aris Meme (Partia Socialdemokrate) propozoi z. Marko Jaku.
z. Pjetër Tushaj hodhi në votim propozimet e bëra. Të pestë emrat u miratuan nga të gjithë këshilltarët.
Në mbledhjen e tij të parë komisioni vendosi të zgjedhë: Znj. Flutura Gjoni – kryetar, z. Dod Jaku – zv/kryetar, Znj. Drimona Marku – Sekretar, z. Klejvi Hoxhiqi – anëtar, z. Marku Jaku – anëtar.
Znj. Flutura Gjoni lexoi Nenin 47 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", "Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit".
Pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur për vërtetimin e mandateve për anëtarë të këshillit të Bashkisë Lezhë, Komisioni konstatoi se marrin pjesë në mbledhje 41 anëtarë. Vërtetohet vlefshmëria e mandateve për 41 anëtarë.
z. Pjetër Tushaj hodhi në votim raportin e Komisionit të Mandateve, i cili u miratua nga të gjithë këshilltarët.
Këshilli quhet i konstituuar pasi marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të mandatuar (marrin pjesë të gjithë anëtarët e mandatuar).
Sekretarja e Këshillit lexoi Formulën e Betimit.
Të gjithë këshilltarët bënë betimin.
Z. Pjetër Tushaj kaloi te pika 1.2 e rendit të ditës "Zgjedhja e kryetarit të Këshillit". dhe pyeti nëse ka dakordësi që Komisioni i

Mandateve të jetë edhe Komision Votimi.
z. Aris Meme (Partia Socialdemokrate) propozoi zëvendësimin e z. Marko Joka me z. Edlir Reçi.
z. Pjetër Tushaj hodhi në votim këtë propozim i cili u miratua me shumicë votash.
z. Pjetër Tushaj kërkoi propozime për Kryetarin e këshillit.
z. Erin Ndreca, në emër të grupit të këshilltarëve socialistë propozoi z. Ndue Duli.
z. Pjetër Tushaj kërkoi propozime të tjera.
Mepë nuk ka propozime të tjera i dha fjalën z. Ndue Duli i cili bëri një prezantim të shkurtër të vetes.
U propozua dhe u dakordësua që votimi për kryetarit e këshillit të bëhej i hapur, megë ishte një kandidaturë e vetme.
39 këshilltarë votuan PRO dhe 2 ABSTENIM (Donika Hoxhia dhe Sovesjon Kosova).
Miratohet.
z. Pjetër Tushaj ftoi z. Ndue Duli për vazhdimin e drejtimit të mbledhjes si kryetar i zgjedhur.
z. Ndue Duli mbajti fjalën e tij përshëndetëse dhe falenderuese, dhe më pas vazhdoi me pikën 1.3 të rendit të ditës "zgjedhje e zëvendëskryetarëve të këshillit Bashkiak" dhe kërkoi propozime nga grupet politike ku tha që sipas ligjit është opozita ajo që i bën e para propozimet.

z. Alfons Treshaj propozoi z. Pjetër Tushaj.
z. Aleksandër Mekaj propozoi znj. Alesia Lleshi.
z. Ndue Luli: Thamë që opozita do këtë një kandidaturë. Duhet të respektojmë barazinë gjinore në kryesinë e këshillit.
Vazhdojmë me propozime të tjera.
z. Erin Ndreca, në emër të grupit socialist propozoi z. Agostin Marku.
z. Flutura Gjoni propozoi z. Donika Hoxhe.
z. Ndue Luli: Mirë është që të unifikohen kandidaturat.
Votimi do bëhet i fshehtë, sepse janë shumë kandidatura.
Meqë janë 3 kandidatura nga opozita dhe do dalë vetëm 1, pozita ka vetëm 1 propozim atëherë kalojmë te votimi për 3 kandidaturat e opozitës.
- z. Agostin Marku sugjeroi që pozita dhe opozita të kenë nga një kandidaturë.
- Të njëjtin diskutim bëri dhe z. Lirim Tonbe.
z. Ndue Luli: N.q.s ju si opozitë mblidheni për 5 minuta dhe bini në konsensus që të sillni një kandidaturë të vetme, atëherë dakord.
- z. Pjetër Tushaj tha që dakordësia duhet të ishte arritur para mbledhjes.
z. Ndue Luli: Atëherë mund të tërhiqemi për të marrë një vendim të përbashkët pa mbani

porosyjë për kandidaturë nga pozita ka dalë.
Alfrida Marku: Zgjidhet zyrtarisht nga opozita dhe në varësi të asaj zgjedhje, zgjidhet zv/kryetari nga pozita.
Anton Ndreu: Nuk mund t'i ndalet e drejta askujt të kandidojë.
Erin Ndreca: ka shumë të drejtë, sepse nuk besoj për e ka rregulloje për kandidaturën e opozitës do e votojë vetëm opozita.
Do e votojnë të gjithë.
- z. Ndue Luli ftoi të ulen këshilltarët e opozitës.
znj. Donika Ndoj propozoi z. Sovejan Kosova.
z. Aleksandër Mekaj propozoi për të vazhdojë kandidatura e znj. Alesia Lleshi që e propozoi më parë.
znj. Donika Hexhia tërhiqet nga kandidimi.
Ndue Luli: Atëherë janë 3 emra nga opozita
1. Pjetër Tushaj, 2. Alesia Lleshi, 3. Sovejan Kosova.
Do të votohet në një fletë votimi për 3 emrat e opozitës dhe për emrin e pozitës.
Të vazhdojë punën komisioni.
- Në përfundim të procesit të votimit, komisioni procedoi me verifikimin dhe numërimin e fletëve të votimit dhe votave për secilin kandidat nga ku rezulton se:
Në votim morën pjesë 40 këshilltarë.
Votat për kandidatët e opozitës:
z. Pjetër Tushaj 3 vota

znj. Alesia Lleshi 28 vota
z. Soveljan Kosova 9 vota

Votat për kandidatin e pozitës:
z. Agostin Marku 31 vota.

Fitues me më shumë vota, për shpallen ZV/kryetarë të këshillit të Bashkisë Lezhë janë znj. Alesia Lleshi nga opozita dhe z. Agostin Marku nga pozita.

z. Ndue Luli: U urojmë suksese ZV/kryetarëve. Vazhdojmë me proceduren e ceremonisë së marrjes së detyrës të kryetarit të Bashkisë.
Në bazë të Vendimit të Gjykatës të datës 12.06.2023, Gjykata ka vendosur vërtetimin e mandatit të kryetarit të Bashkisë Lezhë të z. Pjerin Ndreu, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendore (Kryetar Bashkie), të datës 14.05.2023, sipas vendimit Nr. 645, dt. 02.06.2023, të KQZ-së.

- z. Ndue Luli lexoi formulën e betimit të kryetarit të Bashkisë.
- z. Pjerin Ndreu betohet si kryetari i Bashkisë Lezhë, dhe z. Ndue Luli i vendosi shiritin me ngjyrat e flamurit kombëtar.
- z. Pjerin Ndreu mbajti fjalën e rastit.

- z. Ndue Luli vazhdoi me pikën 3 të rendit të ditës "Zgjedhje e përfaqësuesve të këshillit të bashkisë në këshillin e qarkut. dhe lexoi shkresën e Prefektit për numrin e përfaqësuesve të këshillit Bashkiak Lezhë, në Këshillin e Qarkut Lezhë, ku do jenë 6 përfaqësues, ku 5 nga K.B. Lezhë dhe tjetri - kryetari i Bashkisë Lezhë.
- z. Luli kërkoi propozime për kandidatët nga grupet politike.
- z. Erin Ndreca, nga grupi i këshilltarëve të majtë propozoi znj. Regjina Sokolaj, znj. Joride Mikaj, z. Marko Jaku, z. Anton Ndreu, z. Aris Mema.
- z. Luli kërkoi, nëse ka, propozime të tjera nga grupi opozitar. Mepë nuk ka, kryetari kërkoi miratimin për vendimin e komisionit të votimit me të njëjtën përbërje. U ra dakord me shumicë votash.
- z. Luli ftoi komisionit të vazhdojë punën.
- Në përfundim të procesit të votimit, komisioni procedoi me verifikimin dhe numërimin e fletëve të votimit dhe votave për secilin kandidat, nga ku rezulton se:

Në votim morën pjesë 39 këshilltarë.

Nga procesi i numërimit të votave rezulton:

znj. Regjina Sokolaj 31 vota
znj. Joride Mikaj 33 vota
z. Marko Jaku 29 vota

z. Aris Meme 31 vota.
z. Artan Ndreu 33 vota.

–

të cilët shpallen fitues dhe përfaqësues të këshillit Bashkiak Lezhë në këshillin e Qarkut Lezhë.

–

- Kryetari z. Ndue Luli mbajti fjalën e mbylljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".